Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë
Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

DEKLARATË E PËRPUTHSHMËRISË SË LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME ACQUIS TË BE-së

1. **Organi propozues i aktit normativ:** Ministria e Drejtësisë

2. **Titulli i projekt aktit normativ:** Draft Kodi Civil i Republikës së Kosovës.

3. **Përputhshmëria e aktit normativ me dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ose Marrëveshjes së Përkohshme.**

3.1 dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me përmbajtjen normative të aktit normativ.

NENI 83
Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit

Sa i përket bashkëpunimit të tyre në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, Palët do t'i kushtojnë rëndësi të veçantë konsolidimit të sundimit të ligjit, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi dhe administrimit të zbatimit të ligjit dhe administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht fuqizimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit në Kosovë dhe përmirësimit të efikasitetit të tij, zhvillimin e strukturave të përshtatshme për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët dhe organet tjera gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit për t'i përgatitur ata në mënyrë adekuate për bashkëpunim në çështjet civile, tregtare dhe penale, dhe për t'ju mundësuar atyre që në mënyrë efektive të parandalojnë, hetojnë, ndjekin penalisht dhe gjykojnë krimin e organizuar, korrupsionin dhe terrorizmin

3.2 Afati kohor i përcaktuar për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme.

NENI 74

1. Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkoj gradualisht drejt përputhjes me *Acquis*-in e BE-së. Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të implementohet dhe zbatohet siç duhet.

2. Ky përafrim do të fillon në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e *Acquis*-it të BE-së të cekura në këtë Marrëveshje deri në fund të periudhës transitore të përcaktuar në nenin 9.

NENI 9

Asociimi në mënyre progresive dhe të plotë do të realizohet gjatë një periudhe prej dhjetë vitesh.

3.3 Vlerësimi i nivelit të përmbushjes së detyrimit /obligimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme.

Draft Kodi Civil përmbush tutje obligimin që rrjedh nga MSA-ja sepse përmes këtij draft Kodi synohet avancimi dhe fuqizimi i sundimit të ligjit, ngritja dhe konsolidimi i mëtejmë i institucioneve gjyqësore të pavarura dhe efikase në luftimin e dukurive negative, si korrupsioni, krimi i organizuar, parandalimi i terrorizmit dhe ekstremizmit, etj.

3.4 Arsyet për përmbushjen të pjesshme, ose mosplotësimi/dështimi për përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme.

Nuk zbatohet.

3.5 Ndërlidhja me Programin Kombëtar për Integrim PKI/ PKAA (në rastin aktual ndërlidhja me PVPE).

Ky draft Kod ndërlidhet drejtëpërdrejtë me Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2018-2022, në të cilën ceket hartimi i këtij Draft Kodi – aktiviteti 3.23.1. faqe 259.

4. Përputhshmëria e legjislacionit me *Acquis* e BE-së.

Çështjet civile, kryesisht janë çështje që janë kompetencë e shteteve anëtare dhe aktet e BE-së në këtë kontekst janë të miratuara në kuadër të bashkëpunimit të përforcuar.

4.1 Lista e burimeve primare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria me to.

Nuk zbatohet.

4.2 Lista e burimeve sekondare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria me to.

1. Council Directive 85/374/EEC of 25 July 1985 on the approximation of the laws, regulations and administrative provisions of the Member States concerning liability for defective products.	përputhje

4.3 Lista e burimeve tjera të së drejtës të BE dhe përputhshmëria me to.

1. Rasti C-673/16 i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian *"Relu Adrian Coman and Others v Inspectoratul General pentru Imigrări and Ministerul Afacerilor Interne"* – plotësisht në përputhje.

Vendimi i Gjykatës në këtë rast lidhet në bazë të kërkesës me interpretimin e Nenit 2(2)(a), Nenit 3(1) dhe (2)(a) dhe (b) dhe Nenit 7(2) të Direktivës 2004/38/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 29 Pril 2004 për të drejtën e qytetarëve të Bashkimit Evropian dhe anëtarëve të familjes së tyre që të lëvizin dhe të qëndrojnë lirshëm brenda teritorit të një shteti anëtar, e cila e ndryshon dhe plotëson Rrgulloren (KEE) Nr. 1612/68 dhe i shfuqizon Direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE.

Në këtë rast, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, thekson se *refuzimi i një shteti anëtar për të njohur me qëllim të dhënies së të drejtave për bashkim familjar martesat e gjinisë së njëjtë mes një qytetari të BE-së dhe të një vendi të tretë që është lidhur në një vend anëtar të BE-së gjatë periudhës së rezidencës së qytetarit të BE-së në atë vend, mund të pengoj ushtrimin e së drejtës së lëvizjes së lirë të qytetarit të BE-së.* Po ashtu, në këtë rast të gjykatës, Gjykata thekson se termi "bashkëshort" është në gjininë asnjanëse, andaj kjo mund të i përfshijë bashkëshortë e gjinisë së njëjtë. Termi bashkëshort, në gjininë asnjanëse është reflektuar edhe në Nenin 37, paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Sipas këtij rasti, një qytetar i Bashkimit Evropian mund të i kërkoj shtetit të destinacionit që të pranoj në teritorin e tij, bashkëshortin e gjinisë së njëjtë, *pavarësisht faktit që shteti i tillë e lejon ose martesën mes gjinisë së njëjtë brenda teritorit të tij.*

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sipas këtij rasti, në draft Kodin Civil të Kosovës, nenin 1138 (martesa) i Librit të 4 të Kodit, është precizuar se martesat ndërmjet personave me sekse të njëjta dhe bashkësitë e regjistruara civile janë të lejuara. Kushtet dhe procedura rregullohen me ligj të veçantë.

4.4 Arsyet për përputhje të pjesshme, apo mospërputhje.

Projekt Kodi Civil ka transpozuar legjislacionin relevant të BE-së, përkatësisht një Direktivë dhe rastin e mësipërm të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Sikurse që është theksuar më lartë, e drejta civile mbetet kryesisht kompetencë e shteteve anëtare të BE-së.

4.5 Periudha kohore brenda së cilës është e paraparë realizimi i plotë i perputhshmerisë të legjislacionit me acquis e BE-së.

Nuk aplikohet.

5.Të specifikohet kur nuk ka legjislacion të BE-së me të cilën përputhshmëria është e kërkuar.

Nuk zbatohet.

6. A janë burimet e lartpërmendura të së drejtës së BE-së të përkthyera në gjuhët zyrtare.

Nuk zbatohet.

7. Pjesëmarrja e konsulentëve në hartimin e akteve normative dhe mendimin e tyre për përputhshmërinë (të bashkangjitur shkresat e konsulentëve për hartimin e akteve normative).

Ky draft Kod është hartuar në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Ardian Bajraktari

Drejtor i Departamentit Ligjor

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

__/__/,2021